



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe

EC MA NDARYSHE

THIRRJE PËR OFERTË

Hartim/zhvillim për Udhërrëfyes për Implementimin e Agjendës së Gjelbër në Komunitet e Kosovës

Programi për të drejtat e njeriut, "HumanRigtivism", i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida), ka për qëllim që nëpërmjet shoqërisë civile të përmirësojë të drejtat e njeriut, që janë të natyrshme, origjinale dhe të bazuara në interes të grupit, përmes këtyre tri komponentëve: 1) Të drejtat e njeriut dhe aktivizimi arsimor; 2) Dokumentimi; monitorimi (watchdog) dhe qasja strategjike dhe 3) Të drejtat mjedisore.

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij programi, në kuadër të të cilit shpall këtë thirrje përmes së cilës fton ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për "**Hartimin/zhvillimin për Udhërrëfyes për Implementimin e Agjendës së Gjelbër në Komunitet e Kosovës**".

Dokumenti duhet të ofrojë një udhërrëfyes strategjik që përshkruan hapa dhe mekanizma praktikë për të përkthyer ambiciet e Agjendës së Gjelbër në iniciativë të nivelit lokal brenda komuniteteve të Kosovës. Dokumenti duhet të përmbajë një shqyrtim të Agjendës së Gjelbër dhe Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane, duke u thelluar në bazat e tyre konceptuale, parimet dhe objektivat gjithëpërfshirëse.

Gjithashtu, gjatë hartimit të dokumentit duhet të bëhet rishikim i plotë të Agjendës së Gjelbër dhe Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane; Identifikimi dhe analizimi i sfidave dhe mundësive aktuale mjedisore në komunitet e Kosovës; Hetimi dhe dokumentimi i praktikave më të mira nga rajone të tjera që mund të përshtaten me kontekstin e Kosovës; Zhvillimi i rekomandimeve dhe politikave për zbatimin e Agjendës së Gjelbër në nivel lokal; Analizë e politikave ekzistuese dhe kornizës ligjore në lidhje me mbrojtjen e mjedisit në Kosovë dhe ndryshime të nevojshme dhe Rekomandime mbi fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi të publikut.

Gjatë hartimit/zhvillimit të dokumentit, pala e angazhuar duhet të organizoj takime me përfaqësues të komunitet/drejtorive përkatëse për t'i njoftuar për qëllimin e analizës/hulumtimit; të organizoj takime me njohës të fushave dhe palë tjera të intresit.

Kriteret për ofertim:

- Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim: Për ekspertet/grupet e ekspertëve dërgohen vetëm CV-të e personave përgjegjës;

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ~ Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7, 10000 Prishtinë
www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 029-222-771 & 038-224-967

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit/ OJQ, Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSH- së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së), CV-të e personave që do të angazhohen për realizimin e aktivitetit;
- Oferta duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të metodologjisë së hulumtimit/analizës duke ofruar së paku informata mbi dokumentacionin që do të analizohet, palët që do të përfshihen/kontaktohen dhe strukturën e propozuar të dokumentit. Çmimi duhet të përfshijë koston profesionale dhe ato të transportit;
- Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe;

Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyret e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ose në mënyrë elektronike në info@ecmandryshe.org deri më 26.09.2023 ,ora 15:00 me shënim: **“Hartimi/zhvillimi për Udhërrëfyes për Implementimin e Agjendës së Gjellbër në Komunat e Kosovës”** Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Për pyetje shtesë rreth kësaj thirrjeje mund të na kontaktoni në: info@ecmandryshe.org deri më 22.09.2023

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Vetëm ekspertët /grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të fitues do të informohen/kontaktohen.